


RAPORTI PARAPRAK
I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS
TE AKTIVITETIT:
“RRITJA E SHPENDEVE PER TREGTIM”



Pergatiti materialin : Eko – Studio – Projekt sh.p.k

Tirane, 2015

ADMINISTRATORI

Shkelzen MADANI



PERMBAJTJA

HYRJE

- Shpjegimi I akronimeve
- Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM-se
- Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional
- Pershkrimi i metodikes se zbatuar per hartimin e raportit Paraprak te VNM-se
- Profili I propozuesit
- Vendndodhja
- Pershkrimi I aktivitetit

- a) Pershkrimi I mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi.
- b) Informacion per pranine e burimeve ujore, ne siperfaqene kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij.
- c) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative , ne mjedis, te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer.
- ç) Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis, te tilla si : ujera te ndotura, gaze, pluhur, zhurma, vibrime, si dhe prodhimin e mbetjeve.
- d) Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara.
- e) Mundesia e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot e peraferta per rehabilitimin.
- ë) Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis.
- f) Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille).

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme.

Raporti i *Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis* siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim dhe zbatim te projektit.

Ndikimi → *efekti i nje projekti qe ka ne mjedisin rrethues*

Vleresimi → *analiza qe i behet ketij projekti*

Mjedisi → *elementet abiotike dhe biotike*

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit. Mbrojtja e mjedisit, si nje sistem dinamik, duhet pare ne teresine e faktoreve natyror, dhe te veprimet njerezor qe ushtrohen mbi te. Ato kane nje efekt te fuqishem mbi kushtet e jeteses se popullsise, dhe jane nje element baze per krijime te favorshme ekonomike.

Kur parametrat mjedisore nuk jane konform ligjeve, normave dhe rregullave te mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje te tij dhe prishje te ekuilibrave natyror.

Nxitja e zbatimit te ketyre normave kerkon nje perkujdesje nga ana e organeve legjislative dhe vendimmarrese, ne menyre qe te rritet interesi si dhe detyrimi per ruajtjen e ekuilibrave natyror.

Kjo eshte arritur duke:

- Dhene gjendjen reale nga pikepamja e ndikimit te ketij aktiviteti ne mjedisin human.
- Analizuar faktoret pozitive dhe negative mjedisor.
- Dhene rekomandimet per masat zbutese dhe minimizimin e ndikimeve negative ne mjedis.

Per kete eshte:

- Shfrytezuar informacioni baze i zones.
- Shfrytezuar dokumentacioni juridik dhe teknik te subjektit.

➤ **Metodika e vleresimit te mjedisit**

Hartimi i raportit te VNM-se behet me qellim qe te merren parasysh dhe te analizohen te gjitha faktoret kryesore dhe dytesore qe ndikojne ne mjedis gjate zhvillimit te aktivitetit. Ky raport gjithashtu ka si qellim te jap nje pasqyre te pergjithshme mbi efektet negative e pozitive ne mjedis, alternativat e mundshme dhe masat zbutese te efekteve te padeshirueshme.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultojne nga projekti i propozuar, si gjate zbatimit te tij dhe gjate funksionimit. VNM-ja perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit nepermjet:

- Percaktimit dhe marrjes ne konsiderate te ceshtjeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- Shqyrtimin e alternativave te ndryshme brenda projektit
- Nxjerrjen ne dukje dhe vleresimit cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit
- Propozime per masa zbutese etj

Raporti eshte hartuar per te integruar mbrojtjen e mjedisit ne jeten e perditshme, per te vendosur mjedisin dhe mbrotjen e tij ne qender te vemendjes jo vetem te subjektit por edhe te komunitetit perreth zones.

➤ **Objektivat dhe qellimi i VNM-se.**

VNM ka per objektiva analizimin e faktoreve lokal negative mjedisore, ne dhenien e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative si dhe te tentoje ne permiresimin e vlerave ekologjike e ricikluese te territorit gjate zhvillimit te aktivitetit.

Raporti ka per qellim te sherbeje:

- Si instrument mbrojtjes i mjedisit
- Ne fuqizimin e komunitetit per veprime per mbrojtjen e mjedisit si dhe ne zhvillimin e qendrueshme te burimeve natyrore.
- Ne rritjen e interesimit per bashkepunim dhe ne gjetjen e zgjidhjeve te reja.

Orientimi i raportit te VNM-se u bazua ne:

- Vendi ku do te zbatohet projekti, pasurite natyrore dhe humane te zones
- Identifikimin e ndikimeve negative
- Marrjen e masave zbutese, duke patur parasysh ruajtjen e interesave ekonomike te investitorit
- Masat orientuese per nje zhvillim te qendrueshem

➤ **Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional**

- Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ *Per Mbrojtjen e Mjedisit*”
- Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « *Per Lejet e Mjedisit* »
- Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « *Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis* »
- Urdhri e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 “*Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes*”.
- Udhëzimin nr 8 dt. 27.11.2007 “*Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara*”
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “*Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta*”
- Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “*Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja*”
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “*Per menaxhimin e integruar te mbetjeve*”
- Vendim nr.805 date 4.12.2003 « *Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore* »
- Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « *Per largimin publik te mbeturinave* »
- Udhëzim nr.1 date 03.03.2009 « *Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis* »
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « *Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja* ».
- Udhëzim per dokumentacionin e duhur per “*Leje Mjedisore*”
- Urdhëri Nr. 321 datë 11.2.2014 “*Për Lejet Mjedisore*”
- Udhëzim i MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “*Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së*”
- VKM nr. 686 datë 29.7.2015, “*Për miratimin e rregullave të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore*”.
- Ligji 12.2015 date 26.02.2015 “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011*”*Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis*”.

➤ **PROFILI I PROPOZUESIT**

Subjekti **"DURIM SINANAJ"** Person fizik me administrator **Z. Durim SINANAJ** është regjistruar pranë QKR në datë **dt 11/04/2012**, me numer **NIPT-it L22811401N** për ushtrimin e aktivitetit **"Rritja e shpendeve për tregtim"**.

Me përgatitjen e dokumentacionit përkatës subjekti kërkon të pajiset me Vendim të VNM-se Paraprake sipas Ligji 12.2015 datë 26.02.2015 **"Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011" Per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**" dhe VKM nr. 686 datë 29.7.2015, **"Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"**.

➤ **Vendndodhja**

Aktiviteti do të zhvillohet në rrugën Fier-Patos, Lagjja Portez, Fier. Sipërfaqja totale është **4590m²**, Sipërfaqe trualli **4108 m²**, Sipërfaqe ndertese **1022m²**. Lartësia është 5m.

Kufinjte e tokës ku do të zhvillohet aktiviteti janë:

VERI – Pasuria nr. 524

PERENDIM - Pasuria nr. 283/5

JUG - Pasuria nr. 283/32

LINDJE - Pasuria nr. 283/7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Hogjistimit: FIER Zona Kadastrale Nr. 30.31
 Numri i Pasurisë: 283/K Volumi 5 Faqe 315
 Adresa e Pasurisë: FIER - PORTË
 Lloji i Pasurisë: MRE
 S'përfaqja totale: 4540 m²
 Nga kjo : Sa Truel: -- Nga qo : Sa Ndërtesa: --
 Nga pallat : Kucha e pjesëmarrjea: -- %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotënjtë)

Emri	Atësia	Motemri	Pjesa	Adresa
<u>DURIM KUJTIM SINANAJ</u>			<u>1</u>	<u>FIER. PORTË</u>

- është pronar i PASURISË 283/K
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kullizimet e pasurisë, anë: VEASURIA 524, IPASURIA 283/K, JCPASURIA 283/320 PASURIA 283/5

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga 1 (1) Interesuari (t)
më datë 24.05.2003 Nr. 1739

Data e bësh mit të çertifikatës

E. ENJTE ISHAKOJ

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUES

[Signature]
[Stamp]

HARTA TREGËSË E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJSHME

FIER

J. Edmond

Carly

15/05/2003

FIER

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3031 NR. I PASURISE 283/6 VOL. 8 FO
 INDEKSI I HARTES K-34-M2-124-C1 SHKALLA 1:250
 ADRESA E PASURISE: Rrethi FIER V. PORTO
 Rr. - Pk. -

B. KUFIZIMET

V. PASURIA 524

L. PASURIA 283/7

J. PASURIA 283/32

P. PASURIA 283/5

C. PRONARI

DURIM SINANA

D. Data: 15/05/2003, Ora: 13³⁰





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

**ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE**

Zyra e Regjistrimit FIER Zona Kadastrale Nr. 353
 Numri i Pasurisë 283/7 Volum 8 Faqe 268
 Adresa e Pasurisë FIER- PORTI
 Lloji i Pasurisë PR
 Sipërfaqja totale 1108 m²
 Nga kjo : Sa Tërall _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zëdhënytë)

Emri	Atës a	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>DURIM</u>	<u>MUSTIM</u>	<u>SINANA</u>	<u>1</u>	<u>FIER- PORTI</u>

- është pronar i PASURISË 283/7
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart _____
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
- kufizimet e pasurisë janë : VAMSURIA 523, L PASURIA 283/8, J PASURIA 300/10 PASURIA 283/10

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga i (të) interesuari (t)
më datë 12.03.2022 Nr. 955

Data e lëshimit të çertifikatës

EL FIENIE BUKARIZAD

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI

[Signature]
30/6/22

HEKURAT E TEREKSTRIT

REGISTRIMI I TEREKSTRIT
TEKNIKALIA

FIER
J. Elmord
[Signature]
30/12/2005

A. IDENTIFIKIM I PASURIT

ZONA KLASIFIKIM 3031 PASURIT 283/7 V. 8 EQ 218

INDEKS NËNTER H-34-112-121-C1 SALLA 1: 2500

ADRESA PASURIS: FIER 15 PORTA 2

Rr./L. _____ Nr. _____ K. _____

B. KUPONET C. PROJEKTI


V. PASURIA 524

L. PASURIA 283/8 DURIM SINANAJ


I. PASURIA 283/2

P. PASURIA 283/6

D. Data 12.03.2005 Or. 13⁰⁰



PLANIMETRIA E OBJEKTIT PULARI PORNAR DURIM SINANAJ
KOMUNA PORTEZ FIER
SH 1:100



SIPERFAQJA E TRUALLOT4108M
SIPERFAQJA E OBJEKTIT 1022M2 H 5M
ZONA KADASTRALE 3031 NR PASURISE 28377

HARTOI ING ALEKSANDER RUKAJ
Liç. GJ 0057/3



PRODUCED BY AN AUTODESK EDUCATIONAL PRODUCT

GENTPLANI I PULARISE SE Z DURIM SINANAJ

ZONA KADASTRALE 3031
SHKALLA 1:1000
ADRESA FSHATI PORTEEZ FIER

PRODUCED BY AN AUTODESK EDUCATIONAL PRODUCT

PRODUCED BY AN AUTODESK EDUCATIONAL PRODUCT



PUNOI : TOPOGRAF
GEZIM HAZIZI

TOPOGRAF
GEZIM HAZIZI
121
121
121

PRODUCED BY AN AUTODESK EDUCATIONAL PRODUCT



➤ PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Qellimi i ketij aktiviteti eshte rritja e zogjve te races Brojler, te cilat importohen nga Greqia Italia dhe Maqedonia. Keta zogj merren vetem 24-oresh dhe rriten ne kete kompleks deri ne moshen 45- diteshe ose dhe me teper, moshe ne te cilen fillon tregtimi i tyre. Kompleksi ne te cilin zhvillohet aktiviteti perbehet nga:

- Stalle e perpunimit te ushqimit
- Zyrat e administrates
- Peshorja elektronike
- Shesh per parkimin e automjeteve
- Vend roje
- Stalla per rritjen e zogjve
- Ambient magazinimi i lendve sherbyese

Lendet ndihmese per rritjen e zogjve jane misri, soja, nukleusi, per ngrohje qendore kaldaja me bersi,etj, per rritjen e ketyre zogjve punojne rreth 3 persona. Puna per rritjen e zogjve eshte e organizuar me 1 turn, ne menyre te tille qe zogjte mund te jene nen kontroll per 24 ore, gjithashtu te mund tu hidhet ushqim dhe te kontrollohen te gjitha proceset.

➤ Etapat e rritjes se zogjve

- *Njohja me ambientin me te cilin rritet zogu*

Ambienti me te cilin rritet zogu eshte nje lokal me permasa 43x12 m. Kapaciteti i ketij lokali eshte 150 000 zogj/vit. Per te plotesuar kushtet per rritjen e zogjve ne lokale eshte vendosur nje impiant uji i perber nga tre linja uji, nje impiant per ushqimin e zogjve i perber nga 2 linja ushqimi te kompletuara me pjata dhe me panelin e komanduar automatik, tre linja me ndricues, ventilatoret per qarkullimin e ajrit , aparati i matjes se temperatures dhe paneli elektrik i kontrollit me anen e te cilit behet komandimi ne menyren e duhur e te gjitha proceseve.



- *Pergatitja e lokalit per pritjen e zogjve*

Etapa e pare e pergatitjes se lokalit eshte pastrimi i tij nga mbetjet (plehu) e tufes se pare, me pas behet larja e lokalit, proces te cilit i kushtohet nje rendesi e vecante. Lokali pasi eshte pastruar dhe lare lihet te thahet per disa dite, me pas behet izolimi mbyllja e dritareve, dyerve, aspiratoreve ne menyre qe dizinfektimi te behet sa me mire dhe te japi rezultate sa me pozitive.

Pasi kane mbaruar keto procese behet dezinfektimi i ambientit ne menyre te imtesishme dhe ne sasine e duhur te dizinfektantit dhe lokali lihet i mbyllur per 24 ore. Pas kesaj behet shtrimi i lokalit , i cili behet ne fillim me nje shtrese te holle gelqereje e cila sherben per asgjesimin e ndonje mikrobi qe mund te kete ngelur dhe thithjen e lageshtires. Shtresa e dyte perbehet prej tallashi , ka nje trashesi prej 3-4 cm dhe hapet ne menyre uniforme ne te gjithë lokalin. Ma pas ne lokal futen materialet qe nevojiten si pjatat e ushqimit, pirsset e ujit dhe fibrat per berjen e rrethakeve, montohen linjat e ushqimit dhe pastrohen linjat e ujit ne menyre qe ne rritjen e zogut gjithcka te jete gati.

Etapa e fundit e pergatitjes se lokalit eshte furnigimi , dezinfektim me perzierje formaline dhe permanganate, pas kesaj lokali lihet perseri i mbyllur per te pakten 24 ore. Eshte per tu theksuar fakti qe koha e qendrimit bosh te lokalit midis dy intervaleve te rritjes se zogjve duhet te jete te pakten 2 jave.

- ***Pritja e zogut***

Duke u mbeshtetur dhe ne kushtet klimaterike hapja e lokalit behet 1 ose 2 dite para mberritjes se zogut. Gjate kesaj kohe behet ngrohja e lokalit me ane te ngroheseve qe jane kryesisht me gaz, pergatitja e rrethakeve dhe vendosja e piresve te ujit dhe kupave te ushqimit brenda ne rrethak. Gjithashtu behet larja e linjave te ujit dhe me pas ato lihen te mbushura me uje me sode gje e cila ndihmone ne pastrimin e linjave te ujit dhe ne heqjen e mbeturinave. Arsyeja e krijimit te rrethakeve eshte arritja e temperatures e cila posht ngrohesit ne castin e mberritjes se zogut duhet te jete 30-33 °C.

Ne momentin e mberritjes zogut nuk i hidhet ushqim por vetem uje i cili eshte hedhur ne prerese rreth gjysem ore para mberritjes se zogut. Kjo behet me qellim qe zogu mos te ndiej ndryshimin e temperatures se ambientit me ate te ujit. Me pas rreth 90 min me vone zogut i hidhet ushqimi i cili eshte i bluar imet gati si miell. Transporti i zogut behet me makina te pershtatshme ne menyre qe temperatura te mos jete ne normen e duhur. Cdo ndryshim temperature ndikon ne rritjen e zogjve, pra makinat jane te pajisura me sistem ngrohje dhe ventilimi.

- ***Pershtatja e aparaturave sipas moshes se zogjve***

Ne ditet e para zogu ushqehet si e permendem me siper me pas rreth dites se 3 zogu hiqet nga rrethakja dhe uji thithet ne menyre automatike me ane te linjave te ujit duke lene dhe disa piresse shtese ndersa zogu te mesohet te pije uje ne linja. Menyra e ushqimit vazhdon e njejte si ditet e pare deri ne moshen 10-15 ditesh, me pas vendosen linjat automatike te ushqimit. Pra zogu ushqehet sipas deshires. E rendesishme ne rritjen e tyre eshte temperatura dhe ventilimi. Ne ditet e para temperatura do te jete e larte reth 32 °C me pas kjo temperature ulet me 2 grade gjate nje jave.

Ky ndyshim behet gradualisht . per te patur nje informacion te sakte mbi rritjen e zogjve cdo jave behet peshimi i zogjve duke marr nje pesh mesatare. Ne lokal gjithashtu duhet te kete nje qarkullim te ajrit dhe pastrim te ambientit, kjo realizohet me ane te dritareve por edhe te aspiratoreve. Kur arrin moshen 5-7 ditesh ne lokal vendoset ventilimi automatik, kjo arrihet duke lidhur aparatin e temperatures me aparatin e ventilimit ne kete menyre ventilatoret vihen ne pune vetem kur temperatura kalon mbi temperaturen qe i nevojitet zogut dhe punojne deri sa te arrihet temperatura e deshiruar.



Uji hidhet ne piresse dhe nderrohet disa here ne menyre qe te mos arrij temperaturen e ambientit. Kjo menyre perdoret vetem 4-5 ditet e para me pas zogu hapet ne te gjitha lokalin dhe vihen ne funksionim linjat e ujit me ane te te cilave qarkullon uje i rrjedhshem. Per te mos lejuar ngrohjen e ujit ne fund te linjes vendosen tuba me rrjedhje jashte lokalit ne menyre qe qarkullimi te jete sa me i madh. Ne kete menyre uji mbahet ne nje temperature normale.

- ***Pergatitja e ushqimit dhe perberesit kryesor te tij***

Nje pike e rendesishme ne realizimin me sukses te kesaj veprimtarie eshte edhe ushqimi. Perberesit kryesor jane misri dhe soja. Rreth 80 % te ushqimit e perben misri, soja perben 28 % dhe pjesa tjeter perbehet nga vaji, karbonat dhe nukleusi qe i nevojitet zogut per te marr sasine e duhur te proteinave, energjise dhe gjithcka qe i nevojitet per nje rritje pa probleme. E rendesishme nuk eshte vetem perberja e ushqimit por edhe madhesia e kokrres se ushqimit.

Ne periudhen e pare deri ne 21 dite kokrra e ushqimit duhet te jete shume e vogel, me pas ushqimi behet me i ashper ne menyre qe zogu mund ta konsumoj pa probleme. Pergatitja e ushqimit bluarja dhe perzierja, behen ne nje kapanon i cili ndodhet ne te njejtin territor.

Ne kete kapanon ndodhet nje bluares mulli, dhe nje perzieres , gjate ketij procesi duhet patur parasysh qe imtesia e kokrres se ushqimit dhe koha e perzierjes duhet te jete e duhura. Zogu ushqehet dite-nate me perjashtim te dy ose tre oreve gjate nates, kohe e cila varet nga mosha e zogut.





- ***Rregullat per mbrojtjen nga faktoret e jashtem***

Rendesi e vecante i kushtohet mbrotjes nga faktoret e jashtem per kete perdoret ajo qe quhet karantine, domethen nuk lejohet kalimi i punetoreve dhe materialeve te ndryshem nuk lejohet hyrja e makinave te huaja ne territorin e kompleksit. Makinat perpara se te futen ne kete ambient u behet nje dezinfektim me sperkatje. Per kete ne hyrjen e jashtme te ambientit dhe ne hyrje te cdo lokali eshte vendosur nje grop ne te cilen hidhet uji me perqindjen e duhur te dezinfektanit ne menyre qe cdo kush qe hyne ne lokal te mund te dizinfektoje kembet.

Programi i mbareshtimit te zogjve


Zogjte mbareshtrohen sipas nje programi zooteknik-veterinar te perpiluar nga specialiste perkates. Ky program mbeshtet ne keto pika:

- Normat eventilimit te lokalit
- Normat e ushqimit sipas fazes se rritjes se zogjve
- Pershtatja e temperatures sipas moshes se zogjve
- Programi i vaksinimeve. Me ane te vaksinimit parandalohen semundjet kryesore qe qarkullojne.
- Perdorimi i medikamenteve te ndryshme, me ane te te cileve luftohen infeksionet e mundshme.

a) **Pershkrimi I mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi.**

Nga pikpamja fitoklimatike rajoni i studimit shtrihet në Brezin e pyjeve dhe shkorreteve mesdhetare dhe karakterizohet nga nje diversitet habitatesh dhe komunitetesh bimore, te tilla si vegjetacion i shtretërve të lumenjve, ligatinor i ujrave të embla ose te stadeve te ndryshme te degradimit të tyre, natyrore, gjysem natyrore dhe artificiale apo të krijuar nga aktiviteti njerezor.

Nga analizimi i situatës faunistike në zonë, vihet re një ulje sasiore dhe cilësore e llojeve faunistike. Ekspeditat në zonën Patos - Marinzë, në mjediset bimore përreth lumenjëve Seman, Gjanicë tregojnë për numër të vogël për lloje, dhe vështirësi në takimin e tyre.



Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë rrethi I Fierit dallohet për disa lloje bimesh e kafshesh sidomos ne pjeset bregdetare e fushore. Takohen disa lloje kafshesh si urithi, cakalli, nusja e lales, dhelpra, shkurteza, mellenja, thelleza e fushes si dhe disa lloje te ndryshëm zvarranikesh e gjarprinjsht.



Ndërsa ne ujerat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Rrethi i Fierit bën pjese ne brezin e shkurreve dhe te pyjeve mesdhetare. Shkurret perbehen nga nenkati I makies,ku rriten shkurret me gjelberim te perhershem si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina. Ne këtë nenkat bimor rriten edhe disa drure te lartë si selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger, qe ne disa raste formojne pyje te vegjel.

b) Informacion per pranine e burimeve ujore, ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij.

Ne kuadrin e pasurive natyrore rëndësi te veçantë kanë pasurite ujore, ku përveç detit Adriatik, rrethi pershkohet nga lumenjte Seman, Vjose e Gjanica. Semani -281 km i gjatë formohet nga bashkimi i Devollit me Osumin ne afersi te Beratit.Siperfaqja e pellgut ujembledhes është 5949 km², prurja mesatare vjetore e tij arrin ne 96 m³/sek.Semani është nder lumenjte me eroziv, duke e bërë lumin me eroziv në vend. Vjose - 272 km I gjatë buron nga malet e Pindit ne Greqi.

Siperfaqja e pellgut ujembledhes është 6700 km²,ndërsa prurja mesatare vjetore e tij arrin 195 m³/sek. Gjanica - 67 km buron nga burimet e Pocemit e te Kalivacit.Siperfaqj a e pellgut ujembledhes është 234 km².Është një nga lumenjte me te ndotur në vend, për shkak te derdhjes se naftes. Rrethi ka dhe disa liqene artificiale ku me I madhi e me I rendesishmi prej tyre është ai i Kurjanit me siperfaqe 375 ha, ujerat e tij përdoren për ujitje.

c) **Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative , ne mjedis, te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer.**

o **Ndikimet ne popullsi**

Vendi ku do te zhvillohet aktiviteti eshte larg qendrave te banuara dhe nuk sjell shqetesime per ta vecse rrit mundesin e punesimit te tyre , duke rritur keshtu nivelin ekonomik te ketyre familjeve. Zhvillimi i ketij aktiviteti ka ber te mundur kthimin e nje zone te pashfrytezuar ne nje zone ku do zhvillohet nje aktivitet qe do te sjell te mira e sherbime jo vetem per investitorin por edhe per komunitetin.

o **Ndikimet ne klime**

Gjate zhvillimit te projektit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

o **Ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat qe krijohen jane si rezultat i levizjes se makinave te transportit , zhurma te tjera nuk ka gjate zhvillimit te aktivitetit.

o **Ndikime nga shkarkimi i ujerave**

Gjate zhvillimit te proceseve te larjes se lokaleve pasi nderrohen grupet e zogjve, ujerat e perdorur dekantojne ne gropa septive te posaçme dhe ne momentin qe ato mbyshen mbetjet e tyre groposen ne gropa septike ne pronen e perfaqesuesit te subjektit. Persa i perket ujerave te reshjeve si atyre te perdorimit nga personeli ato i bashkohen kanalizimit kryesor te zones.

o **Ndikimet ne toke**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk gjenerohen mbetje te ngurta te cilat te perbejne rrezik per ndotjen e tokes, jashteqitjet e zogjve pasi trajtohen ne kompleks shkojne per perdorim te pleherimit te tokes nga ana e fermereve. Mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti i pergjithshem i personelit shkon ne vendet e caktuara nga pushteti lokal. Persa i perket mbetjeve qe dalin nga procesi i therjes se zogjve si pendet , kokat, kembet shkojne ne gropa te hapura nga drejtues te shoqerise te cilat jane prone e perfaqesuesit te shoqerise Durim Sinanaj.

○ **Ndikimet ne ajer**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk kemi aktivitet prodhues qe te gjeneroj gaze ne atmosfere, pra nuk do te ket ndikime negative ne ajer si rezultat i ketij aktiviteti. Persa i perket aromave te pakendeshme nga ana e investitorit eshte bere e mundur mbjellja e territorit perreth lokaleve me lule dekorative dhe gjelberim te perhershem . Per mirembajtjen e tyre tregohet nje kujdes i vecante nga ana e personelit.

○ **Ndikimet e projektit ne rruget lokale dhe te transportit.**

Ndikim më i madh në trafikun tokësor do të vijë nga ardhja e mjeteve per sjelljen e zogjve apo marrjen e zogjve te therur ku do zhvillohet aktiviteti por Zhvillimi i tij nuk sjell ndryshime ne rruge lokale dhe transport, apo te rris trafikun.

○ **Ndikimi i projektit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike**

Nga zbatimi i projektit nuk ka dhe nuk do te kete impakt negativ mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore, sepse ne kete zone dhe per rreth saj, nuk ka objekte te kesaj natyre ose te nje rendesie te vecant te karakterit te mesiperm.

○ **Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitet duke perfshire ndikimet nderkombetare**

Nga zhvillimi i aktivitetit , ne zonen ku zhvillohet dhe territorin per rreth, nuk ka dhe nuk jane parashikuar ndikime individuale apo te grumbulluara ne biodiversitet. Objekti eshte ne brendesi te territorit te Republikes se Shqiperise, prandaj dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

○ **Ndikimet ne perdorimin e tokes**

Ky aktivitet nuk ka ndikim negative ne perdorimin e tokes bujqesore, nuk do te perdoret siperfaqe tjeter toke pervec asaj te miratuar per kete qellim.

○ **Ndikimet ne ekonomi**

Persa i perket ndikimeve ekonomike ky aktivitet duke qene aktivitet i rritjes se shpendeve sjell ndikime pozitive ne ekonomi duke rritur te ardhurat jo vetem te investitorit por duke punesuar edhe punonjes nga zona perreth rrit nivelin e tyre te jetes.

ç) **Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis, te tilla si : ujera te ndotura, gaze, pluhur, zhurma, vibrime, si dhe prodhimin e mbetjeve.**

- ***Shkarkimet ne uje***

Sistemi i furnizimit te kompleksit me uje per nevojat jetesore eshte i mbyllur, pahumbje i kontrolluar ne menyre automatike dhe praktikisht pa asnje mundesi shkarkimi ne ujerat e ambientit. Pjesa tjetere e ujit rrjetit ujembledhes te instaluar ne kompleks depozitohet ne vasken e ndertuar per kete qellim, ku i nenshtrohet trajtimit me klor per nje periudhe 5 ditore. Pra gjate punes normale te aktivitetit nuk kemi shkarkime ne mjedisin ujqor prites qe e ndot ate.

- ***Emetimet ne ajer***

Ndertesa ne te cilen mbareshtrohen zogjte eshte nje ndertese me konstrukcion blloqe me cati, dhe ka dritare ajri ndermjete catise dhe tavanit. Ne kete menyre garantohet termoizolimi i nevojshem, gje qe jep mundesi qe nepermjet krijimit te nje mikroklimes optimale, me te gjitha parametrat e nevojshem jetesor kompleksi te funksionojte pavarisht kushteve te jashtme te ambientit. Per te plotesuar nevojat per oksigjen ne lokal jane vendosur 2 aspirator me fuqi kembimi 3500 m³ ne ore te cilet komandohen nga sistemi i matjes se temperatures ne varesi te temperatures dhe lageshtise se kerkuar.

Per te ulur ne minimum pluhurat qe mund te krijohen ne pjesen e fundit te nderteses ku ndodhen ventilatoret, instalohet nje sistem i cili i bllokoi. Ky sistem perbehet nga nje rrjet e imet speciale ne te cilen sprucohet uje me presion 100 bar ne intervale kohore 3 min pune dhe 3 min pushim. Ky veprim krijon efektin e mjegulles dhe ne kete menyre pjesezat e pluhurit grumbullohen ne siperfaqen e kufizuar te ketij sistemi. Pra duke pare se lokalet kane izolim dhe pavarisi te plote nga ambienti i jashtem edhe emetimet e mundshme ne ajer si pluhurat, zhurmat, nxehtesia, vibracionet jane praktikisht ne nivel 0 dhe pa pasoja negative ne mjedis.

- ***Mbetjet e ngurta***

Ne kete lokal sasia ditore nga jashteqitjet e zogjve eshte 1 ton ne dite. Plehu depozitohet poshte pjeses se baterise (vendqendrimi i shpendeve) ne nje sistem i cili eshte i perber nga tallashi me trashesi 5-7 cm. Gjate qendrimit per rreth 45 dite ne kete lokal plehu thahet me anen e sistemit qe eshte shtruar.

